



Znj. Jonida Gjoka

**PËRGJEGJËSE E SEKTORIT
TË SHËRBIMEVE NR.2, FIER**

Profili

Diplomuar për Drejtësi në Fakultetin e Shkencave Humane, Universiteti Ismail Qemali , Vlorë në vitin 2014. Më pas ka vazhduar Masterin Profesional për Shkenca Administrative po në këtë universitet, ku gjatë vitit të parë të studimeve është vlerësuar me Certifikatë për rezultate të larta mësimore. Gjatë viteve 2019-2021 znj. Gjoka ka ndjekur studimet Master Shkencor në degën E Drejtë Private, në Univeristetin Aleksandër Moisiu, Durrës.

Karrierën e saj profesionale znj. Gjoka e ka nisur në nëntor të vitit 2014, ku ka qënë e punësuar si Specialiste në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një projekti 3 mujor të Roskovec Language School dhe Bankers Petroleum. Në vitin 2016 ka filluar punë si specialist juriste në ZVRPP Fier ku fillimisht është marrë me procesin e azhurnimit të Zonave Kadastrale dhe Legalizimit. Më pas ka punuar si jurist në firmën Modeste Sh.p.k ku ka dhënë konsulencë juridike, përfaqësimin me palët e treta etj. Karriera e saj ka vazhduar sërish në institucionet shtetërore ku në vitin 2019 ka nisur punë si Sekretare pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, ku ndër të tjera ka dhënë konsulencë juridike, si edhe është marrë me redaktim aktesh të brendshme. Në vitin 2020 nëpërmjet programit të ekselencës nga Departamenti i Administratës Publike, ka filluar punë si Specialist Juriste në Sektorin Juridik në Instiutcionin e Prefektit të Qarkut Fier ku puna e saj konsistonte në verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativë të organeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, konsulencë juridike, ndjekja e proceseve gjyqësore etj. Në vitin 2021 znj. Gjoka ka nisur punë si specialist Jurist Borxhi pranë Degës Doganore Fier, ku ka qënë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve doganore, evidencën e borxhit si edhe proceset gjyqësore.

Në korrik të vitit 2022 nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele znj. Gjoka bëhet pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, në pozicionin Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore, ku vazhdon edhe sot. Gjatë këtyre viteve znj. Gjoka ka ndjekur trajnime të ndryshme në fushën e metrologjisë, por jo vetëm, trajnime si “Metrologjia e Masës”, “Koncepte të verifikimit të instrumentave të peshimit jo-automatik”, etj. Gjithashtu në vitin 2023 ka marrë titullin Specialist në Administrimin Publik nga Akademia Profesionale ELITA.

Znj. Gjoka është njohëse e gjuhës Angleze.

jonida.gjoka@dpm.gov.al